

Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

**No. Prot:** PR- 0007

**Data:** 19/03/2025

## FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrueshmerine tone.

Qendrueshmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

### **I. Hyrje**

Banka ProCredit eshte e interesuar per sherbimin e perkthimit per nevoja te saj.

Per realizmin e ketij sherbimi Banka eshte e interesuar te kontraktoje shoqeri/person fizik qe permbushin te gjitha kerkesat dhe kualifikimet e duhura per kryerjen e sherbimeve te nevojshme te cilat perfshihen ne menyre te detajuar ne Aneksin 1 bashkangjitur kesaj ftese.

Per realizimin e ketyre sherbimeve Banka mund te kontraktoje per nje periudhe bashkepunimi dy vjet, me shume se nje shoqeri apo person fizik.

### **II. Objekti i Fteses per Oferte**

**Realizimi sherbimit te perkthimit per nevoja te ProCredit Bank.**

Kjo Ftese per Oferte perbehet nga:

1.	Ftesa per Oferte	3 faqe
2.	Aneksi Nr. 1	1 faqe
3.	Aneksi Nr. 2	1 faqe
4.	Deklarata e gjendjes gjyqesore	1 faqe
5.	Deklarata e Njohjes dhe Perputhshmerise	1 faqe
6.	Kushtet paraprake te kontrates	1 faqe
7.	Aneksi Nr.3	1 faqe
8.	Formulari i Ofertes	1 faqe

### III. Oferta

Oferta juaj duhet te perbehet nga:

**A. Oferta Ligjore**, e cila paraqet *Kriteret e Pranimiit/Kualifikimit dhe* duhet te perpilohet sipas kerkesave te renditura me poshte.

1. Ekstraktit historik per te dhenat e shoqerise leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit.
2. Nje dokument qe verteton se subjekti juaj i ka plotesuar dhe shlyer detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqerore, leshuar nga Administrata Tatimore.
3. Deklarate per gjendjen gjyqesore te shoqerise sipas formatit bashkengjitur kesaj ftese per oferte.
4. Çertifikatat e perkthyesve zyrtar te autorizuar per perkthyesit e gjuhes angleze qe do te angazhohen ne perkthimet e Bankes.

#### Shenim:

*Dokumentacioni i kerkuar ne Kriteret e Pranimiit/Kualifikimi ne pikat nga 1 dhe 2, duhet te vertetohet permes dokumentave te leshuar jo me pare se tre muaj nga data e fundit e dorezimit te ofertes. Dokumentat e mesiperme mund te paraqiten origjinal/ te noterizuar ose kopje te dokumentave origjinale. Ofertuesit te shpallur fitues do ti kerkohet ky dokumentacion ne origjinal ose fotokopje te noterizuar.*

**B. Oferta teknike (Kriteret e vleresimit te cilesise)**

1. Kapaciteti teknik dhe eksperiencia te ngjashme:

Shoqeria juaj, duhet te provoje se disponon aftesite teknike per realizimin e objektit te kerkuar, ne kete proces tenderimi permes dokumentacionit si me poshte:

- CV e detajuar e subjektit per aktivitetin qe nga data e themelimit ku te perfshihen te gjitha eksperiencat tuaja te meparshme si dhe eshte e preferueshme te kemi kopje te punimeve te realizuara. Pjese e CV-se (ne rastin e shoqerise) duhet te jete dhe perberja e stafit ku te detajohen kualifikimet e tyre profesionale apo cdo sqarim shtese<sup>1</sup> qe konfirmon kualifikimin e tyre per kryerjen e sherbimeve te kerkuara.
- Leter reference leshuar nga institucione te ndryshme private apo publike per te cilet subjekti juaj ka kryer realizime te ngjashme se bashku me kopjet e kontratave perkatese.

**C. Oferta Ekonomike**

Subjekti duhet te respektojte formatin e kesaj Ftese per Oferte ne kuotimin e kerkuar.

Ju duhet te paraqitni oferten tuaj sipas Aneksit Nr.1 me çmimet perkatese (te gjitha kostot e paparashikuara ne kete ftese per oferte duhet te perfshihen ne cmim). Tvsh duhet te jete e perfshire ne cmim.

*Deklarata e Njohjes dhe Perputhshmerise:* Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Deklarata e Njohjes dhe Perputhshmerise qe duhen firmosur/vulosur nga subjekti juaj dhe te dergohen se bashku me oferten tekniko-ligjore.

*Formulari i Ofertes:* Bashkangjitur me ftesen per oferte eshte Formulari i Ofertes i cili duhet te firmoset/vulohet nga subjekti juaj dhe te dergohet se bashku me oferten ekonomike.

---

<sup>1</sup> Per stafin e propozuar per kete sherbim eshte e preferueshme te kemi dhe kopje te punimeve te realizuara

#### **IV. Dorezimi i Ofertes**

Oferta juaj duhet te dergohet ndarazi:

**1. Dokumentacioni ligjor dhe teknik dhe 2. Oferta ekonomike** qe duhet te dorezohet ne forme elektronike ne adresen : [info\\_procurement@procredit-group.com](mailto:info_procurement@procredit-group.com);

#### **V. Vleresimi i Ofertes**

- Ne perfundim te ketij procesi, Banka ruan te drejten te perzgjedhe, propozimin me te pershtatshem per nevojat e saj.
- **Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte date 1 Prill 2025, ora 16.00.**
- Pas ketij afati Banka do te studioje ofertat tekniko - ligjore te derguara dhe do te realizoje takime me subjektet e ofruara nese do te jete e nevojshme.
- Banka ruan te drejten te lidhe kontrate bashkepunimi me me shume se nje subjekt.

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: [info\\_procurement@procredit-group.com](mailto:info_procurement@procredit-group.com).

Banka do te njoftoje me shkrim nese ju jeni fitues ose jo per procesin e tenderimit.

Per cdo ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne: [albanekesaprokurime@procredit-group.com](mailto:albanekesaprokurime@procredit-group.com)





## **Aneksi Nr. 1**

### **Specifikimet teknike dhe/ose pershkrimi i punes**

Sherbimi i perkthimit kerkohet per gjuhen angleze dhe oferta financiare e juaj do te jete per kete gjuhe. Kjo nuk perjashton mundesine qe per nevoja te saj Banka mund te kerkoje dhe sherbimin e perkthimit ne gjuhen gjermane, maqedonase etj dhe nese subjekti juaj e ofron kete sherbim mund te dergoni oferten tuaj.

Dokumentacioni qe kerkohet te perkthehet eshte kryesisht me natyre ekonomike dhe ne do te vleresonim shume bashkepunimin me subjekte te cilat kane eksperienca e nevojshme ne kete fushë. Dokumentat e kerkuara mund te jene marreveshje, licenca, raporte te ndryshme auditi dhe per burimet njerezore.

Per dokumentat e konsideruar me konfidencialitet te larte, sherbimi i perkthimit do te realizohet prane ambjenteve te Bankes dhe ky eshte nje **kusht i detyrueshem** per vendosjen e marredhenies se bashkepunimit.

Ne lidhje me volumin eshte e pak e veshtire per te perlogaritur po frekuenca me e larte eshte nga anglishtja ne shqip. Materialet jane kryesisht licenca, marreveshje, raporte te ndryshme auditi dhe HR. Dokumentacioni qe kerkohet te perkthehet nga shqipja ne anglisht dergohet ne zyrat tona ne Gjermani ndersa ato qe perkthehen ne shqip perdoren nga Banka ose palet e treta te interesuara.

Subjekti eshte i detyruar te sjelle materialin e perkthyer ne format MS Word dhe materiali perfundimtar i perkthyer do te sillet vetem pas konfirmimit te draftit te tij nga Banka.

Subjekti duhet te realizoje sherbimin e perkthimit ne menyre profesionale duke perdorur terminologjine e duhur bazuar ne natyren e materialit te kerkuar.

**Aneksi Nr. 2**

Afatet kohore te realizimit te sherbimit

Lutemi te specifikoni afatet kokore te realizimit te sherbimit si ne tabelen me poshte:

Pershkrimi	Numri i faqeve te perkthyer ne jave
Sherbim perkthimi nga Anglishtja ne Shqip	
Sherbim perkthimi nga Shqipja ne Anglisht	

**Shenim i rendesishem:**

- Afatet kohore te propozuara do te jene pjese e kontrates dhe objekt penaliteti ne rast te mospermbushjes se tyre. Ky aneks duhet te perfshihet ne oferten tekniko-ligjore.
- Ne kerkesen e mesiperme lutem te konsideroni 1 faqe me 2200 karaktere (perfshire hapesirat). Llogaritja do te behet mbeshtetur ne materialin e perkthyer .

## Kushtet paraprake te kontrates

### Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:

- 1.1 Objekt i kontrates eshte perkthimi i materialeve nga gjuha e angleze ne shqip ose anasjelltas. Banka do te vere ne dispozicion te Perkthyesit dhe Perkthyesi do te perktheje personalisht keto materiale sipas kerkeses se Bankes.
- 1.2 Kerkesat per perkthimin e materialeve dergohen tek Perkthyesi ne forme elektronike (pdf/word) ose te printuara duke percaktuar afatin se kur do te kthehen te perkthyer keto materiale. Ne raste kur Banka gjykon se materiali per perkthim eshte teper konfidencial Perkthyesi do te perktheje materialin ne ambientet e Bankes.
- 1.3 Afati i Kontrates eshte per nje periudhe dy vjecare.
- 1.4 Pagesa kryhet ne llogarine e Perkthyesit prane Bankes ProCredit sh.a. brenda 30 (tridhete) diteve nga kryerja e sherbimit dhe leshimi i fatures tatimore nga Perkthyesi. Ofertuesi i shpallur fitues duhet te hap llogari prane Bankes ProCredit , nese nuk ka, perpara nenshkrimit te kontrates.
- 1.5 Banka rezervon te drejten te ktheje ose te mospranoje nje perkthim te caktuar duke kerkuar rishikim te punes se realizuar nese sherbimi i ofruar nuk permbush standartet e kerkuara.

## Ofruesi i Sherbimit

Vertetoj se kam lexuar, kuptuar Ftesen per Oferte dhe ne perputhje me kerkesat e saj bashkangjitur gjeni oferten e

Ofruesi i Sherbimit: \_\_\_\_\_

Nenshkrimi i autorizuar: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_



## Deklarata e Njohjes dhe Perputhshmerise

Grupi ProCredit pranon se ndikimet etike, sociale dhe mjedisore qendrojnë brenda zinxhirit të furnizimit. Për më tepër, ndikimet pozitive mund të arrihen nepermjet blerjes së produkteve dhe/ose shërbimeve me të përgjegjshme dhe duke punuar në bashkëpunim me furnizuesit për të ndikuar pozitivisht reciprokisht në performancën etike, sociale dhe mjedisore. Prandaj, grupi ProCredit pret që furnizuesit/kontraktoret e tij të angazhohen për një sërë standardesh minimale për të siguruar që angazhimi i tyre ndaj çështjeve kyçe sociale, mjedisore dhe qeverisëse janë në përputhje me standardet e larta të ProCredit.

### 1. Përputhshmëria me Listen Perjashtimore të ProCredit

Siç është rasti me klientet e tij, grupi ProCredit pret që furnizuesit dhe kontraktoret e tij të mos angazhohen në asnjë prej aktivitetet e listuara në Listen Perjashtimore të ProCredit. Në përgjithësi kjo listë përfshin, por nuk kufizohet në sa vijon:

- i. Prodhimi ose aktivitetet që përfshijnë forma të demshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së demshme të femijëve, praktika diskriminuese ose praktika që pengojnë punonjësit të ushtrojnë ligjerisht të drejtat e tyre të shoqërisë dhe marrëveshjeve kolektive (shih pikën a) të Listës së Perjashtimit për detaje të metejshme)
- ii. Respektimi i ligjeve ose rregulloreve kombëtare, si dhe i konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti ose aktiviteti (shih pikën w) të Listës Perjashtimore për detaje të metejshme)

### 2. Pastrimi i parave

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij t'u përmbahen vlerave etike të grupit ProCredit dhe të konfirmojnë se ata nuk marrin pjesë në asnjë nga format e pastrimit të parave (shih gjithashtu Kodin e Sjelljes).

### 3. Parandalimi i korrupsionit dhe mashtrimit

Siç përkruhet në Kodin e Sjelljes, grupi ProCredit nuk toleron rryshfet ose korrupsionin. Për këtë arsye, asnjë marrëdhënie biznesi nuk mund të krijohet ose të vazhdojë, nëse një furnizues i mundshëm mendohet të jetë i përfshirë në korrupsion dhe/ose mashtrim. Kjo shërben për të theksuar se grupi ProCredit nuk pranon asnjë rryshfet të çfaredo forme dhe nuk i lejon furnizuesit të angazhohen në praktika të tilla. Çdo furnizues ose kontraktor që zbulohet se është i përfshirë në aktivitete të kësaj natyre do të përjashtohet nga të qenit partner i mundshëm.

### 4. Respektimi i të drejtave të njeriut

Grupi ProCredit ndjek Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (1948) dhe pret që furnizuesit dhe kontraktoret e tij të bëjnë të njëjten gjë.

### 5. Shëndeti, siguria, sigurimi dhe mjedisi (SHSSM)

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij t'i marrin seriozisht çështjet e SHSSM duke u siguruar që të jenë në linjë me dhe në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me SHSSM.

Grupi ProCredit pret që furnizuesit e tij të angazhohen dhe t'u përmbahen me vertetësi standardeve të përcaktuara në këtë dokument. Furnizuesit pritët të tregojnë perkushtimin e tyre duke bashkëpunuar ngushtë me grupin ProCredit dhe duke ofruar akses të arsyeshëm në dokumentacionin/informacionin perkates nëse gjykohet e nevojshme. Në rast të shkeljeve serioze dhe/ose të vazhdueshme të standardeve të përcaktuara këtu, grupi ProCredit do të ndermarre hapat e nevojshëm për të nderprerë marrëdhënien e biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruetit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkuar ne emer te furnizuesit dhe per t'u angazhuar per standardet e percaktuara ne kete dokument.

Deklarata te nenshkuhet nga furnizuesi/kontraktori

Emri i kompanise \_\_\_\_\_

Numri i regjistrimit (nese ka) \_\_\_\_\_

Numri i kontrates/tenderit (nese ka) \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Emri dhe titulli i nenshkruetit \_\_\_\_\_

Data

Nenshkrimi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_



### DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E subjektit pjesemarres ne proceduren e prokurimit qe do te zhvillohet ne date \_\_\_\_\_ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt \_\_\_\_\_

Une i nenshkruari \_\_\_\_\_ me cilesine \_\_\_\_\_ te shoqerise \_\_\_\_\_ deklaroj se:

- Shoqeria \_\_\_\_\_ nuk eshte denuar per shkelje penale,
- Shoqeria \_\_\_\_\_ nuk eshte denuar me vendim te gjykates se formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqeria \_\_\_\_\_ nuk eshte ne proces falimentimi

Data e dorezimit te deklarates \_\_\_\_\_

Perfaqesuesi i ofertuesit

Nenshkrimi

Vula

**ZARFI I OFERTES EKONOMIKE DUHET TE PERMBAJE SI ME POSHTE:****ANEKSI Nr. 3: Oferta ekonomike:**

Oferta ekonomike duhet te jete e shprehur ne Leke dhe te perfshije te gjitha detyrimet tatimore. Ajo duhet te jete e detajuar sipas aktiviteve qe kerkon ky sherbim si ne tabelen e meposhtme.

Nr.	Lloji i sherbimit	Njesia	Sasia	Cmimi pa TVSH	Totali	Totali me TVSH
1	Perkthim nga Anglishtja ne Shqip	faqe	1			
2	Perkthim nga Shqipja ne Anglisht	faqe	1			

- Ne kerkesen e mesiperme lutem te konsideroni 1 faqe me 2200 karaktere (perfshire hapesirat). Llogaritja do te behet mbeshtetur ne materialin e perkthyer .
- Ne rast te ofrimit te sherbimit dhe ne gjuhe te tjera lutemi te jepni oferten tuaj.

## FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]

Date: \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_\_  
 [plotesoni daten (dite, muaj, vit) e dorezimit te ofertes]  
 Numri i fteses :.....:

Per: **ProCredit Bank**  
**Funkcioni Prokurimit**  
**Tirane, Shqiperi**

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerkesat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;
- (b) Ne sigurojme furnizimin ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levrimet per Mallrat dhe Sherbimet respektive si me poshte \_\_\_\_\_ [plotesoni shkurtimisht mallrat, apo sherbimet respektive];
- (c) Ne permbushim gjithë kerkesat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike, te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: \_\_\_\_\_ [plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];
- (e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.....;
- (f) Nese oferta jone do te pranohet, ne angazhohemi te mbajme nje garanci kontrate ne perputhje me dokumentat e tenderit nese kjo eshte e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit, do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose çdo oferte tjeter qe ju mund te merrni.

Firmosur: \_\_\_\_\_

Date: \_\_\_\_\_



